

Ligji 106/2013 dt.28.03.2013

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 22 pika 4, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.”.

Neni 2

Në nenin 32, në fund të pikës 2 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) taksa për zënien e hapësirës publike nuk aplikohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.”.

Neni 3

Në fund të nenit 33 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Antenat e telefonisë celulare, si dhe çdo lloj antene tjetër transmetimi, të vëna në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nuk janë subjekt i taksave me karakter të përkohshëm.”.

Neni 4

Në nenin 35, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Nuk konsiderohen tarifa, në kuptim të këtij ligji dhe të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”, tarifat e antenave të telefonisë celulare, si dhe të çdo lloj antene tjetër transmetimi, të vëna në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 28.3.2013

Shpallur me dekretin nr. 8097, datë 12.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani